FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 6	2002	Mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 62, datë 7.3.2002	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të Vilës 30 ……	119
Vendim i KM nr. 64, datë 7.3.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Kashar dhe për lidhjen e tij me sistemin 110 kV, Tiranë ……	119
Vendim i KM nr. 65, datë 7.3.2002	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik…….	121
Vendim i KM nr. 66, datë 7.3.2002	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maltës për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike……	123
Vendim i KM nr. 67, datë 7.3.2002	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë për bashkëpunimin për zhvillim……..	125

Vendim i KM nr.71, datë 7.3.2002	Për dhënien e emrit "Nënë Tereza" Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit…….	127
Vendim i KM nr.72, datë 7.3.2002	Për një shtesë në vendimin nr. 579, datë 8.9.1998 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e rregullave për kthimin e vlerave financiare kreditorëve që kanë depozituar kapitalet e tyre pranë shoqërive huamarrëse", ndryshuar me vendimin nr. 531, datë 22.11.1999 të Këshillit të Ministrave ……	127
Vendim i KM nr. 74, datë 14.3.2002	Për lejimin e përdorimit të procedurës së prokurimit "Tender i hapur", me afat të përshpejtuar, për ndërtimin e dozatorit të karbonit aktiv në Impiantin e Bovillës në Tiranë ……	128
Vendim i GjK nr. 35, datë 5.3.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 916, datë 26.7.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit)……	128
Vendim i GjK nr. 36, datë 7.3.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 140, datë 17.2. 1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 268, datë 6.5.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. D- 46, datë 5.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.……	131
Vendim i GjK nr. 37, datë 7.3.2002	Me objekt interpretimin e vendimeve nr. 10, datë 31.10.1995, nr.7, datë 10.4.1998 dhe nr. 57, datë 4.11.1998 të Gjykatës Kushtetuese.……..	133
Vendim i GjK nr. 38, datë 11.3.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 471, datë 24.5.1996 të Gjykatës së Rrethit Sarandë; nr. 199, datë 17.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 34, datë 11.4.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë……..	135
Vendim i GjK nr. 40, datë 11.3.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 8472, datë 8.4.1999 "Për rikthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga personat fizikë e juridikë, nëpërmjet shitjes së pasurive apo transaksioneve të pronësisë"……	138
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ali Ymeraj……	141

\

V E N D I M
Nr. 62, datë 7.3.2002

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË VILËS 30

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 14 e 15 shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institutit të Trajnimit të Administratës Publike t'i jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, Vila 30, me të gjithë territorin përreth. Instituti nuk ka të drejtë t'ua japë në përdorim, pa shpërblim apo me qira, të tretëve mjediset e kësaj vile.

2. Ngarkohet Instituti i Trajnimit të Administratës Publike të përballojë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në përdorim.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare t'i bëjë dorëzimet përkatëse të kësaj prone të paluajtshme Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

4. Pika 5 e kreut I "Për rrethin e Tiranës" të listës nr.1 të vendimit nr.34, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajnimin e personaliteteve të larta" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 64, datë 7.3.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 KV, KASHAR DHE PËR LIDHJEN E TIJ ME SISTEMIN 110 KV, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve dhe bashkëpronarëve, që preken nga ndërtimi i nënstacionit elektrik 110/20 kv, Kashar, dhe për lidhjen e tij me sistemin 110 kv, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen nga KESH sh.a., në vlerë të plotë, për sipërfaqen prej 8301 m2, truall në shumën e përgjithshme prej 35 694 300 (tridhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind) lekësh, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e miratuara për KESH sh.a-në, në kuadër të "Konventës financiare ndërmjet Qeverisë të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për "Programin e ndihmës për të mbështetur sektorët ekonomikë".

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit, në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë, të jenë në ngarkim të KESH sh.a-së, kërkuesit për shpronësim.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2002.

7. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Rrethi Tiranë
Bashkia Vorë
Fshati Kashar

Lista e pronarëve të pasurisë pronë private objekt shpronësimi për interes publik "Për ndërtimin e nënstacionit 110/20kV Kashar dhe lidhjen e tij me sistemin 110 kV Tiranë"

Nr	Emër Mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Nr. parcelës	Zona kadastrale	Sip. totale m2	Çmimi i truallit lekë/m2	Vlera e kompensimit në lekë	Shpenzime procedurale
1	Sefer Fucia	Yrshek Tiranë	truall	2/7	2679	25	4300	107.500	Publikime =59.000 lekë
2	Haxhi Luzi	Yrshek Tiranë	truall	2/10	2679	3375	4300	14.512.500 lekë	Shpërblim i anëtarëve të komisionit = 30.000 lekë
3	Agim Luzi	Yrshek Tiranë	truall	2/11	2679	2625	4300	11.287.500 lekë	Shpenzime kancelerie =11.000 lekë
4	Selami Luzi	Yrshek Tiranë	truall	2/12	2679	2128	4300	9.150.400 lekë	
5	Hysni Luzi	Yrshek Tiranë	truall	2/13	2679	148	4300	636.400 lekë	Totali i shpenzimeve =100.000 lekë

Shuma totale për kompensim = 35.694 300 lekë

V E N D I M
Nr. 65, datë 7.3.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË PËR BASHKËPUNIMIN TREGTAR DHE EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratohet marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË MBI BASHKËPUNIMIN TRAGTAR DHE EKONOMIK

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovakisë, më poshtë të quajtura "Palët",

duke kërkuar zgjerimin e tregtisë reciproke dhe marrëdhënieve të bashkëpunimit ekonomik bazuar në parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok, në përputhje me legjislacionin e vendeve të tyre dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare,

duke patur parasysh ndryshimet e bëra në ekonominë e të dy vendeve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

(1) Palët do të nxisin zhvillimin reciprok të tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik, duke u përqëndruar në zgjerimin e prodhimit reciprok të mallrave dhe volumin e shërbimeve të parashikuara.

(2) Palët kanë rënë dakord të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar, lehtësuar dhe stimuluar forma të ndryshme të tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik, në përputhje me legjislacionin e të dy vendeve.

Neni 2

(1) Palët do t'i japin njëra-tjetrës statusin e kombit më të favorizuar në lidhje me importin dhe eksportin e mallrave me origjinë nga vendet e të dy Palëve.

(2) Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk do të zbatohen për avantazhe, lehtësira, dhe përjashtime, që Palët kanë parashikuar apo do të parashikojnë për:

a) vendet fqinje me qëllim mbështetjen apo lehtësimin e tregtisë ndërkufitare;

b) shtete që i përkasin një bashkimi doganor apo zone të tregtisë së lirë, në të cilën një nga Palët është anëtare.

Neni 3

(1) Importet dhe eksportet e mallrave dhe shërbimeve do të realizohen në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, legjislacionin dhe rregullat ligjore të vlefshme në shtetet e Palëve, të drejtën ndërkombëtare dhe sipas marrëveshjeve të bëra ndërmjet personave fizikë dhe juridikë të autorizuar të Palëve.

(2) Asnjëra nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse për detyrime apo dëmtime të personave fizikë apo juridikë të autorizuar, që rezultojnë nga marrëveshje të tilla tregtare.

Neni 4

Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet personave fizikë dhe juridikë të autorizuar të të dy vendeve në fushën e industrisë, bujqësisë, energjisë, kërkimit dhe përdorimit të burimeve natyrore, ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, në realizimin e projekteve të përbashkëta e investimit të kapitaleve në fushat me interes të përbashkët, duke përfshirë bashkëpunimin me vendet e treta.

Neni 5

(1) Çdo Palë ka të drejtë të kërkojë që mallrat e eksportuara ndërmjet shteteve të Palëve të kenë "Certifikatën e origjinës", të lëshuar për ato nga autoriteti përkatës i vendit eksportues, siç kërkohet nga rregullat në atë vend.

(2) Licencat e eksportit dhe importit do të jepen në përputhje me rregullat ligjore kombëtare të shteteve për ato mallra dhe shërbime për të cilat kërkohet një licencë e tillë. Licencat e eksportit dhe importit do të jepen brenda kohës dhe kushteve, të cilat janë jo më pak të favorshme se ato të

parashikuara për ndonjë subjekt të një vendi të tretë dhe janë në përputhje me dispozitat e nenit 2, këtu më sipër.

Neni 6

Palët, në përputhje me rregullat e tyre ligjore kombëtare, të vlefshëm në të dy vendet, do të përjashtojnë nga detyrimet doganore taksat dhe të tjera detyrime, të lidhura me importin dhe eksportin, mallrat e mëposhtme:

a) mostrat dhe materialin për reklamë pa vlerë tregtare,

b) mallrat për panaire dhe ekspozita, duke përfshirë mallra të cilat Palët i shkëmbejnë bashkërisht në bazë të një lejeje për përdorim të përkohshëm të mallrave, në përputhje me rregullat ligjore kombëtare në rast se këto nuk janë të përcaktuara për qarkullim të lirë.

Neni 7

(1) Pagimi i transaksioneve sipas kësaj marrëveshjeje do bëhet në një monedhë të konvertueshme, në përputhje me rregullat ligjore të brendshme të vlefshme në të dy shtetet e Palëve dhe të së drejtës ndërkombëtare.

(2) Në raste të veçanta, personat e autorizuar fizikë dhe juridikë nga shtetet e Palëve mund të bien dakord për një formë të ndryshme pagewe.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje që rezulton nga interpretimi apo ekzekutimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime dhe me bisedime të përbashkëta ndërmjet Palëve. Nëse nuk mund të arrihet marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me metoda të njohura nga e drejta ndërkombëtare.

Neni 9

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo të amendohet me shkrim, mbi bazë konsensusi të ndërsjellë të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 10

(1) Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet miratimit në përputhje me rregullat ligjore kombëtare të të dyja palëve dhe do të hyjë në fuqi në datën e shkëmbimit të notave që konfirmojnë miratimin e brendshëm.

(2) Ditën kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi, Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative Çeke e Sllovake për Tregtinë e Ndërsjellë dhe Pagesat pas 1 Janarit, 1992, nënshkruar më 23 janar 1992 në Tiranë, do të pushojë së qeni në lidhje me Republikën Sllovake.

(3) Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë kohe të papërcaktuar. Secila nga Palët mund t'i japë një njoftim me shkrim Palës tjetër. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë gjashtë muaj pas datës së dërgimit të njoftimit me shkrim Palës tjetër.

(4) Angazhimet sipas kësaj Marrëveshjeje ndërkohë të marra, por ende të paplotësuara deri në datën e mbarimit të kësaj Marrëveshjeje do të rregullohen nga dispozitat e saj deri në plotësimin e tyre përfundimtar.

Bërë në Tiranë më 23.10.2000, në dy origjinale, secili në gjuhët shqipe, sllovake dhe angleze, ku të gjitha tekstet kanë të njëjtën vlerë. Në rast të ndonjë ndryshimi në interpretim, do të mbizotërojë teksti anglisht.

Për Qeverinë e
Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e
Republikës së Sllovakisë

V E N D I M
Nr. 66, datë 7.3.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALTËS PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratohet marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maltës për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALTËS MBI HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Maltës, më tej të quajtura Palë Kontraktuese,

Me dëshirën për të lehtësuar hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre ndërmjet dy vendeve,

Kanë rënë dakort si më poshtë:

Neni 1

Anëtarët e Misioneve Diplomatike dhe Konsullore dhe Organizatave Ndërkombëtare të akredituara në secilin shtet, ashtu si dhe anëtarët e familjeve të tyre, si dhe mbajtësit e tjerë të pasaportave diplomatike do të kenë të drejtën të hyjnë pa vizë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Atyre do t'u jepet e drejta e qëndrimit për 30 ditë pas mbërritjes.

Neni 2

Hyrja dhe dalja e qytetarëve të shteteve të Palëve Kontraktuese, mbajtjes të pasaportave diplomatike, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të bëhet nëpërmjet pikave zyrtare të hyrjes në të dy vendet.

Neni 3

Kjo Marrëveshje nuk përjashton qytetarët e të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit tjetër.

Neni 4

Secila Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën të refuzojë hyrjen e qytetarëve të Palës tjetër

Kontraktuese ose të revokojë autorizimin e qëndrimit të dhënë më parë për këta persona, nëse ata kryejnë shkelje ndaj ligjeve dhe rregullave të tij.

V E N D I M
Nr. 67, datë 7.3.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SUEDISË PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë për bashkëpunimin për zhvillim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SUEDISË PËR BASHKËPUNIM PËR ZHVILLIM 5 PRILL 2001-31 DHJETOR 2002

Qeveria e Shqipërisë (këtu e më poshtë referuar si Shqipëria) dhe Qeveria e Suedisë (këtu e më poshtë referuar si Suedia),

Me dëshirën për të bashkëpunuar me qëllim zbutjen e varfërisë dhe për të kontribuar më tej në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social dhe të nxisë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe barazinë midis burrit dhe gruas në Shqipëri, në mënyrë më të veçantë në drejtim të objektivave të mëposhtme:

- të nxisë qeverisjen e mirë nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të institucioneve demokratike dhe të zhvillimit të shoqërisë civile;
- të nxisë zhvillimin e një ekonomie tregu të qëndrueshme nga ana sociale, e cila mund të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm dhe zbutje të varfërisë;
- të nxisë stabilitetin në rajon.

Duke qenë dakord që përgjegjësia për zhvillimin e bashkëpunimit nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje i mbetet Shqipërisë ndërsa roli i Suedisë kufizohet në sigurimin e burimeve siç detajohet në marrëveshjet e veçanta,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Fushat e bashkëpunimit

Projektet/programet për bashkëpunimin do të përcaktohen në marrëveshjet e veçanta ndërmjet Palëve.

Fushat kryesore të bashkëpunimit do të jenë këto:

- administratat publike dhe qeverisja lokale,
- bujqësi,
- shëndetsi,
- ambient,

- bisnesi dhe financa dhe
- të drejtat e njeriut dhe demokracia.

Neni 2
Delegimi i fuqive

Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim SIDA dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë në Shqipëri do të autorizohen të përfaqësojnë qeveritë e tyre përkatëse në çështjet që i përkasin zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Referimi me marrëveshjet e tjera

Programi i zhvillimit të bashkëpunimit do të udhëhiqet gjithashtu nga:
- Marrëveshja mbi Termat e Përgjithshme dhe Kushtet për Bashkëpunim për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë, dhe
- marrëveshjet e veçanta për fushat e ndryshme të bashkëpunimit.

Neni 4
Mbledhje pasuese vjetore

SIDA do të parapërgatisë mbledhjet vjetore pasuese me Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë.

Neni 5
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të dy Palët dhe do të jetë e vlefshme deri në 31 dhjetor 2002. Nëse nuk ka marrëveshje të re për bashkëpunim për zhvillim dhe të përfunduar për periudhën mbas kësaj date, aktivitetet e projektit, sipas marrëveshjeve të veçanta të cilat janë akoma të vlefshme, mund të zbatohen në përputhje me kushtet e secilës marrëveshje të veçanta.

Kjo Marrëveshje mund të përfundohet me anë të një njoftimi me shkrim, të bërë gjashtë muaj me përpara, nga secila Palë.

U nënshkruan dy tekste origjinale të kësaj Marrëveshje të shkruara në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e SHqipërisë	Për Qeverinë e Suedisë
Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	AgjenCia ndërkombëtare Suedeze, për zhvillimi dhe bashkëpunim

V E N D I M
Nr. 71, datë 7.3.2002

PËR DHËNIEN E EMRIT "NËNË TEREZA" AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË RINASIT

Në mbështetje të neneve 95 pika 2 dhe 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit t'i jepet emri "Nënë Tereza".
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 72, datë 7.3.2002

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 579, DATË 8.9.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET E TYRE PRANË SHOQËRIVE HUAMARRËSE", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 531, DATË 22.11.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 dhe nenit 13 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 "Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.579, datë 8.9.1998 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.531, datë 22.11.1999 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 4/1 të shtohet pika 4/2, me këtë përmbajtje:

"4/2. Personi, i cili është shpallur debitor në shoqërinë huamarrëse në administrim dhe që njëkohësisht është edhe kreditor, i lind e drejta të kërkojë kompensimin e plotë të detyrimit debitor me atë kreditor vetëm në rast se vlera financiare, e tërhequr prej shoqërisë huamarrëse, për të cilin është shpallur debitor nga administratori, është depozituar në shoqëri, për efekt përfitimi prej tij si kreditor.

Në këto raste, administratorët e shoqërisë huamarrëse në administrim marrin vendim për mbulimin e detyrimit debitor me atë kreditor apo për kthimin e shumave të përfituara tepër prej interesave të tërhequra si kreditor".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 74, datë 14.3.2002

PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT “TENDER I HAPUR”, ME AFAT TË PËRSHPEJTUAR, PËR NDËRTIMIN E DOZATORIT TË KARBONIT AKTIV NË IMPIANTIN E BOVILLËS NË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizmeve sh.a. Tiranë që, me fondin prej 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekësh, nga buxheti i miratuar për vitin 2002 për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, në zërin "Investime", të përdorë procedurën e prokurimit "Tender i hapur" me afat të përshpejtuar, jo më pak se 10 ditë nga dita e shpalljes së ftesës për ofertë deri në ditën e dorëzimit të saj për ndërtimin e dozatorit të karbonit aktiv në Impiantin e Bovillës në Tiranë.

2. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 35, datë 7.3.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli	Anëtar i	""
Alfred Karamuço	Anëtar i	""
Kujtim Puto	Anëtar i	""
Kristofor Peçi	Anëtar i	""
Tefta Zaka	Anëtare e	""
Petrit Plloçi	Anëtar i	""
Sokol Sadushi	Anëtar i	""
Zija Vuci	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.1.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.208/10 Akti që i përket:

KËRKUES: SERAFIN KRISTO, përfaqësuar nga avokat Kujtim Capo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. ANDREA VENEDIKU
2. KASTRIOT XHYMERTI
3. DEGA E ANGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT KORÇË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 916, datë 26.7.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 134 dhe 142/1 të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi ka parashtruar si shkak parregullsinë e procesit ligjor të zhvilluar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Sipas tij, kjo parregullsi konsiston në këto drejtime:

1. Duke vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e Këshillimit, ky kolegj ka marrë atribute që nuk i takojnë atij. Ai ka pretenduar se në rekurs ka ngritur probleme ligjore, të cilave mund t'u jepej përgjigje jo në Dhomën e Këshillimit, por vetëm në seancën gjyqësore, pasi të jetë zhvilluar më parë një gjykim me pjesëmarrjen e palëve.

2. Vendimi objekt - kërkesë është i paarsyetuar dhe nuk u jepet përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs lidhur me shkeljet e ligjit të lejuara nga gjykata e rrethit dhe ajo e Apelit Korçë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.170, datë 8.2.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit Serafin Kristo, pranimin e kundërpadisë së subjekteve të interesuara Hysen Nebiu e Kastriot Xhymerti dhe detyrimin e AKP-së, dega Korçë, t'i kthejë kërkuesit dhe subjektit tjetër të interesuar Andrea Venediku shumën prej 38521 lekë, të marrë padrejtësisht nga shitja dy herë e truallit të objektit të privatizuar.

Mbi ankimin e kërkuesit Serafin Kristo, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.380, datë 19.12.2000, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të sipërm të gjykatës së shkallës së parë.

Duke mos qenë dakord me këtë zgjidhje, i lartpërmenduri ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Civil i kësaj Gjykate ka vendosur në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.916, datë 26.7.2001, mospranimin e këtij rekursi si të pabazuar në ligj.

Është vetëm vendimi i kësaj instance gjyqësore që kërkuesi insiston të shfuqizohet nga Gjykata Kushtetuese si i papajtueshëm me Kushtetutën.

Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kërkuesi Serafin Kristo dhe subjekti i interesuar Andrea Venediku kanë privatizuar bashkërisht në vitin 1994 lokalin e një floktoreje në qytetin e Korçës. Dy subjektet e tjerë të interesuar, Kastriot Xhymerti e Hysen Nebiu, që edhe këta kanë qenë berberë në këtë lokal, kanë kërkuar në rrugë gjyqësore pavlefshmërinë e pjesshme të këtij veprimi juridik.

Të ndodhur përpara kësaj situate, kërkuesi dhe Andrea Venediku janë pajtuar me kërkesën e tyre dhe për realizimin e saj kanë ndërmarrë konkretisht këto veprime:

Kërkuesi i ka shitur Andrea Venedikut gjysmën e pjesës së tij takuese në këtë lokal, kurse ky i fundit gjysmën tjetër të këtij objekti, që ishte pjesa e tij, ia ka shitur Kastriot Xhymertit dhe Hysen Nebiut. Këto shitje janë bërë me akt noterial dhe secili prej tyre është bërë pronar në 1/4 pjesë të lokalit.

Në vitin 1996, kërkuesi Serafin Kristo dhe Andrea Venediku, duke qenë pronarë të vetëm të lokalit kanë blerë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, dega Korçë edhe truallin nën të e përrreth tij.

Kjo e fundit, e nisur përsëri nga qëllimi për t'i përfshirë Kastriotin dhe Hysenin edhe në privatizimin e truallit, i ka shitur këtyre vetëm gjysmën e tij, sadoqë në momentin e shitjes kjo pasuri nuk ndodhej në pronësi të saj. MegjithAtë, kalimin në pronësi të sipërpërmendurve të kësaj pasurie, gjykata e ka konsideruar të drejtë, por këtë veprim juridik ajo e ka deklaruar pjesërisht të pavlefshëm vetëm për shkak se Agjencia Kombëtare e Privatizimit, dega Korçë është paguar për të dytën herë me çmimin e shitjes. Mbi këtë bazë kjo është detyruar që shumën e marrë tepër t'ia kthejë kërkuesit dhe subjektit të interesuar, Andrea Venediku.

Gjykata Kushtetuese, duke i analizuar në dritën e këtyre të fakteve shkaqet që ka parashtruar kërkuesi në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, arrin në përfundim se aty nuk ngrihen probleme me karakter ligjor. Ai ka bërë përpjekje për t'i paraqitur këto probleme si të tilla, por duke i vlerësuar provat ndryshe nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit.

Kështu, meqenëse shitjet e bëra me akt noterial dhe të regjistruara në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të përfunduara këto midis kërkuesit dhe Andrea Venedikut ose midis këtij dhe dy subjekteve të tjerë të interesuar, Kastriot Xhymertit e Hysen Nebiut, janë kryer duke respektuar formAt e kërkuara nga ligji, gjykatat nuk mund të vinin në dyshim vlefshmërinë e këtyre shitjeve, duke pranuar, siç ka pretenduar kërkuesi, mungesën e vullnetit të tij për të hyrë në këto marrëdhënie juridike. Edhe fakti se bashkëshortja e tij nuk figuron si palë në kontratën e shitjes së lokalit, nuk i jep atij të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e këtij veprimi juridik, me pretendimin se në këtë rast nuk është respektuar e drejta e saj e parablerjes. Për kërkimin e kësaj të drejte në rrugë gjyqësore legjitimohet vetëm ajo dhe jo kërkuesi.

Po ashtu, të pabazuara janë edhe pretendimet e tij në lidhje me parregullsinë e kontratës së shitjes së truallit, e lidhur kjo midis Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, dega Korçë dhe subjekteve të interesuar, Kastriot Xhymerti e Hysen Nebiu. Këtë parregullsi gjykata e ka ndrequr duke e detyruar Agjencinë Kombëtare të Privatizmit, dega Korçë t'i kthejë kërkuesit dhe Andrea Venedikut kundërvleftën e gjysmës së truallit që kjo e ka marrë prej tyre.

Me këtë zgjidhje të bazuar në provat e administruara, gjykata me të drejtë ka pranuar se për

zbatimin e drejtë të ligjit dhe të akteve të tjera nënligjore "Për privatizimin e pasurisë shtetërore", duhet të marrin pjesë në blerje të gjithë pjesëmarrësit në proces, si ish-punonjës në këtë lokal.

Për rrjedhojë, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e këtij rekursi, i marrë nga ky në Dhomën e Këshillimit, nuk përbën proces të parregullt ligjor. Ky Kolegj, në këtë rast, ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk ka marrë atribute që i takojnë seancës gjyqësore.

Nga ana tjetër, edhe arsyetimi i këtij vendimi nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në këtë drejtim. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në Dhomën e Këshillimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 36, datë 7.3.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i""
Alfred Karamuço	Anëtar i""
Kujtim Puto	Anëtar i""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Zija Vuci	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21.1.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.221/17 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA "BESA", SHËRBIMI I ROJEVE CIVILE DURRËS, përfaqësuar nga avokat. Liljana Ruli, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: FILIALI I TELEKOMIT DURRËS, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.140, datë 17.2. 1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr.268, datë 6.5.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. D-46, datë 5.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 131/f i Kushtetutës; nenet 467/e dhe 472/a të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas kërkuesit, shfuqizimi i vendimeve të paraqitura në objektin e kërkesës duhet të bëhet për

këto shkaqe:

1. Mosmarrja e provës vendimtare për zgjidhjen e drejtë të procesit gjyqësor ka sjellë dhënien e një vendimi të paligjshëm. Thirrja nga gjykata e specialistëve kompetentë do të sqaronte nëse mund të vendoseshin kartat telefonike në ambientet e Filialit apo duheshin dërguar në Bankë.

2. Mungesa e hetimit të mënyrës së administrimit të vlerave monetare dhe letrave me vlerë ka penguar zhvillimin e një procesi gjyqësor të ligjshëm dhe si pasojë zgjidhjen e drejtë të çështjes.

3. Mosrespektimi i urdhërimeve të ligjeve materiale lidhur me administrimin e letrave me vlerë e ka çuar gjykatën në përfundime të padrejta e të kundërligjshme.

4. Në rekursin në interes të ligjit kemi parashtruar vetëm shkaqet ligjore të mësipërme, por Kolegji Seleksionues nuk e ka kaluar çështjen për gjykim, duke cenuar kështu të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Krostofor Peçi, përfaqësuesen e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Shoqëria e Shërbimit të Rojeve Civile "Besa" sh.p.k. me qendër në Durrës, në bazë të kontratës së lidhur me Filialin e Furnizimit të Telekomit Durrës, ka marrë përsipër ruajtjen e objekteve në bazë të një shpërblimi të parashikuar në kontratë. Sipas procesverbalit të mbajtur nga subjekti i interesuar, Filiali i Telekomit Durrës rezulton se, në datën 27.3.1998, në objektet e tij janë vjedhur 20473 karta telefonike me vleftë 2.256.125 lekë.

Nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës është filluar çështja penale, por në datën 22.5.1998 vendoset pezullimi i hetimeve për shkak të moszbulimit të autorëve të krimit. Mbi padinë e Filialit të Telekomit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur detyrimin e Shoqërisë "Besa" të shpërblejë dëmin e shkaktuar në shumën e mësipërme. Vendimi është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ndërsa Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

Kërkuesi pretendon se vendimet e mësipërme të gjykatave të të tri shkallëve janë antikushtetuese për shkak të shkeljeve të rënda të normave të Kodit të Procedurës Civile dhe për injorim të kërkesave urdhëruese të ligjeve materiale lidhur me administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare. Sipas tij, gjykatat, për zgjidhjen e drejtë të çështjes, ishin të detyruara të zgjeronin hetimin gjyqësor për të sqaruar mënyrën e administrimit të vlerave monetare e letrave me vleftë dhe të merrnin në pyetje për këtë ekspertë kompetentë. Moskryerja e këtyre veprimeve argumentohet në kërkesë, ka sjellë si pasojë shkeljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në bazë të nenit 42/1 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese çmon se këto pretendime të kërkuesit nuk janë të bazuara. Si në rekurs edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkuesi ka ngritur probleme që kanë të bëjnë me kushtet e kontratës, për të cilat gjykatat që kanë gjykuar çështjen janë shprehur me vendim. Mospranimi nga ana e tyre i pretendimeve të kërkuesit për rrethanat konkrete të çështjes nuk do të thotë se është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Duke bërë një interpretim të kontratës lidhur me detyrimet që palët kanë marrë përsipër, gjykatat kanë arritur në përfundimin se dëmi është shkaktuar për faj të kërkuesit. Pra, ky interpretim i kontratës i bërë nga gjykatat pas shqyrtimit të çështjes nuk përmban në aspektin kushtetues elementë të procesit të parregullt ligjor.

Në këto kushte, edhe pretendimi tjetër i kërkuesit se Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë duke injoruar kërkesat e ligjit ka shkelur në mënyrë flagrante parimin kushtetues për në proces të rregullt ligjor, nuk është i bazuar. Ky Kolegj është kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur nëse rekursi i paraqitur përmban ose jo shkaqe ligjore. Është pikërisht detyrë e Kolegjit në Dhomën e Këshillimit që të shqyrtojë dhe vlerësojë shkaqet e ngritura në rekurs janë ose jo nga ato që kërkon ligji. Në rast se këto shkaqe, ndonëse paraqiten si ligjore, në fakt nuk janë të tilla, por kanë të bëjnë me vlerësimine provave, Kolegji në Dhomën e Këshillimit ka të drejtë të vendosë mospranimin e rekursit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 37, datë 7.3.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	""
Gjergj Sauli	Anëtar i	""
Alfred Karamuço	Anëtar i	""
Kujtim Puto	Anëtar i	""
Tefta Zaka	Anëtare e	""
Petrit Plloçi	Anëtar i	""
Sokol Sadushi	Anëtar i	""
Kristofor Peçi	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.222/18 Akti që i përket:

KëRKUES: HASAN LAÇAJ, përfaqësuar nga avokatët Dilaver Rexhepi e Nexhdet Kambo, me deklarim.

Subjekte të interesuara:

1. KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR, përfaqësuar nga avokatët Dilaver Rexhepi e Nexhdet Kambo, me autorizim.

2. Kisha ortodokse autoqefale, në mungesë.
3. Sindikata e Albturizmit Shkodër, në mungesë.
4. Agjencia kombëtare e privatizimit, në mungesë.
5. Shoqëria Tregtare "Rozafa", përfaqësuar nga avokat Lili Robo, me deklarim.

Objekti: Interpretimi i vendimeve nr.10, datë 31.7.1995; nr.7, datë 10.4.1998 dhe nr.57, datë 4.11.1998 të Gjykatës Kushtetuese.

Në kërkesën e tij për interpretim të këtyre vendimeve kërkuesi parashtron këto shkaqe:

1. Interpretimi i vendimeve duhet të bëhet me qëllim që të gjejë zbatim e drejta e parablerjes (privatizimit) të Hotel "Rozafa".
2. Në interpretim të përcaktohet që e drejta e parablerjes të realizohet duke zbatuar ligjin, i cili ka qenë në fuqi ditën e dhënies së këtyre vendimeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të

interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Mbi kërkesën e kërkuesve Hasan Laçaj etj., me objekt shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.275, datë 5.6.1995 "Për formën e privatizimit të disa objekteve pronë shtetërore", vetëm për pjesën ku është vendosur privatizimi i Hotel "Rozafa" Shkodër, Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar çështjen dhe, me vendimin nr.10, datë 31.7.1995, ka shfuqizuar vendimin e mësipërm, ndër të tjera me arsyetimin se vjen në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 21 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" ku thuhet: "Në trojet e zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte etj., ish-pronari ka të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve, kur privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi".

Gjykata Kushtetuese, pasi ka shqyrtuar kërkesën e Hasan Laçajt, me vendimin nr.7, datë 10.4.1998, shfuqizoi si antikushtetues vendimin nr.83, datë 21.1.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se kërkuesi, duke qenë ish-pronar i një pjese të truallit nën objekt, legjitimohet për të kërkuar njohjen e së drejtës së mohuar nga një veprim juridik i kryer nga një i tretë. Ndërsa me vendimin nr.57, datë 4.11.1998, Gjykata Kushtetuese ka shpallur antikushtetues vendimin nr.927, datë 4.6.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me të cilin ishte vendosur mospranimi i çështjes për shqyrtim, në kundërshtim me vendimin e mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë mënyrë, sipas vendimeve të lartpërmendura të Gjykatës, kërkuesit i njihet e drejta e parablerjes, në bazë të nenit 21 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Sipas kërkesës së paraqitur për interpretimin e këtyre vendimeve, kërkohet të përcaktohet që e drejta e parablerjes së objektit në konflikt, të ndërtuar mbi truallin ish-pronë private, të realizohet duke zbatuar ligjin, i cili ka qenë në fuqi në kohën e dhënies së vendimeve.

Në bazë të nenit 80 pika 1 germa "a" të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Gjykata Kushtetuese ka të drejtë "të intepretojë vendimin në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen". Sipas kësaj dispozite, që të bëhet interpretimi i vendimit duhet të ekzistojnë dy elementë që kanë të bëjnë me kuptimin e tij dhe që janë dyshimi ose marrëveshja. Këto duhet të jenë të tilla që ta bëjnë vendimin të pakuptueshëm e, për rrjedhojë, të pazbatueshëm. Por, në rastin konkret, njohja e së drejtës së parablerjes, duke cituar në vendim nenin përkatës të ligjit që mbron dhe garanton këtë të drejtë, nuk e bën vendimin të dyshimtë dhe as krijon ndonjë mosmarrëveshje për kuptimin e tij. Përkundrazi, përmendja e dispozitës ligjore, e cila përbën thelbin e vendimit, e bën këtë të fundit më të qartë e më të zbatueshëm. Kërkesa që të bëhet interpretimi për të sqaruar që e drejta e parablerjes dhe privatizimi i objektit të realizohen duke zbatuar ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e dhënies së vendimeve, i kalon caqet ligjore të interpretimit dhe do të ndryshonte përmbajtjen e vendimit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i ka njohur në fakt të drejtën e parablerjes sipas ligjit, por jo të shprehet për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte, çka do të bënte që çështja të dilte jashtë juridiksionit kushtetues. Problemet që mund të lindin më vonë në praktikë për kërkuesin dhe vështirësitë e privatizimit të objektit nuk kanë të bëjnë me kuptimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por me realizimin e së drejtës së tij të njohur me ligj.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa për interpretim të vendimeve të lartpërmendura është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 134/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 80 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren

Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 38, datë 11.3.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 18.12.2001 dhe 17.01.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.211/11 Akti që i përket:

KËRKUES: SKËNDER MUÇO, përfaqësuar nga avokat Fatmir Gjika.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. XHEMAL KALO, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari.
2. NDËRMARRJA E GRUMBULLIMIT TË DRITHRAVE, SARANDË, në mungesë.
3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE pranë Bashkisë Sarandë, në mungesë.

OBJEKTI:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.471, datë 24.5.1996 të Gjykatës së Rrethit Sarandë; nr.199, datë 17.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.34, datë 11.4.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se vendimet e sipërcituara janë rezultat i zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 dhe 131 shkronja "f" të Kushtetutës. Ai ka parashtruar këto shkaqe kryesore për shfuqizimin e tyre si antikushtetues:

- Në Gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar gjykimi në mungesë, sepse pala e paditur (kërkuesi) ka kërkuar shtyrjen e gjykimit për arsye, sipas tij, të përligjura, por gjykata ka vazhduar gjykimin, duke shpallur vendimin përfundimtar. Një nga anëtarët e trupit gjykues nuk ka nënshkruar vendimin e gjykatës.
- Gjykata e Apelit ka zhvilluar gjykimin në mungesë të kërkuesit, duke mos e njoftuar për ditën dhe orën e gjykimit, pasi sipas dispozitave të kohës së shqyrtimit të çështjes duhej detyrimisht të njoftohej me fletëthirrje.
- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë gjykuar çështjen në mungesë të dosjes gjyqësore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr.471, datë 24.5.1996, ka pranuar padinë dhe e ka anuluar pjesërisht vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pranë Bashkisë Sarandë, duke njohur pronar mbi një banesë paditësit Xhemal e Violeta Kalo. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.199, datë 17.1.1997, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke saktësuar vetëm sipërfaqen mbi truallin e ndërtesës.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.34, datë 11.4.2001, kanë vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kjo çështje e shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese paraqet një veçanti, pasi dosja gjyqësore e krijuar gjatë gjykimit në shkallën e parë rezulton e humbur dhe për këtë arsye nuk u administrua gjatë këtij procesi gjyqësor kushtetues.

Për të arritur në një përfundim sa më të drejtë, Gjykata Kushtetuese i analizoi dhe i vlerësoi të gjitha pretendimet e ngritura nga palët në këtë gjykim kushtetues vetëm mbi dokumentet, të cilat ndodhen aktualisht në dosjen e formuar rishtazi gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të bëjë një pasqyrim dhe një analizë të të gjitha pretendimeve të palëvë në proces, duke i ballafaquar ato me dokumentacionin e administruar në seancë gjyqësore, me qëllim arritjen në një konkluzion sa më të drejtë.

Lidhur me pretendimin e parë të kërkuesit për zhvillimin e gjykimit në mungesë në Gjykatën e Rrethit Sarandë, nuk rezulton në pjesën hyrëse të vendimit nr.471, datë 24.5.1996 të jetë pasqyruar mungesa e palës së paditur (kërkuesit) në gjykim. Në dispozitivin e vendimit, gjykata ka pranuar se për palën e paditur afati i ankimit fillon nga marrja njoftim prej saj, duke konfirmuar në këtë mënyrë mungesën e palës së paditur në gjykim, por jo shkaqet e kësaj mungese. Ndërsa pretendimi tjetër i kërkuesit për mosnënshkrimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë nga një prej anëtarve të trupit gjykues, bazohet në një deklaratë noteriale të lëshuar nga ky person, por ky fakt kundërshtohet, në të njëjtën formë, nga kryesuesi i trupit gjykues, ndërkohë që origjinali i vendimit nuk figuron në dosje. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese e çmon këtë pretendim si të pabazuar.

E njëjta situatë gjendet pothuajse edhe për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Pretendimin për zhvillimin e gjykimit në mungesë në këtë Gjykatë, kërkuesi e mbështet në mospasjen e njoftimit zyrtar për ditën dhe orën e gjykimit, kërkesë kjo që ligji procedural i kohës e parashikonte si një detyrim për Gjykatën e Apelit. Një argument shtesë për mospasjen dijeni të zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Apelit kërkuesi e gjen duke arsyetuar me mungesën e rekursit në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit, ndërkohë që ushtrimi i të drejtës për të bërë rekurs në rast të një dijenie për gjykimin në shkallë të dytë, sipas tij, do të ishte veprimi më i domosdoshëm dhe më i thjeshtë për të.

Duke iu referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykata Kushtetuese konstaton se në pjesën hyrëse të tij nuk rezulton e evidentuar mungesa e ndonjë pale në proces, ndërkohë që në pjesën që paraqet pretendimet përfundimtare të palëve për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, nuk figuron prezenca e tyre.

Pretendimet për zhvillimin e gjykimit në mungesë në gjykatat e të dyja shkallëve janë parashtruar nga kërkuesi edhe në rekursin në interes të ligjit drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës sï Lartë, por, që në mungesë të plotë të dosjes gjyqësore, janë vlerësuar nga kjo gjykatë si të pabazuara, me arsyetimin se nuk janë shoqëruar me akte apo dokumente shkresore, detyrim ky që, sipas arsyetimit të vendimit të Kolegjeve, bie mbi palën që e paraqet rekursin.

Nga pikëpamja formale, pretendimet që ngrihen nga ana e kërkuesit përpara Gjykatës Kushtetuese përfshihen në konceptet që jurisprudenca e saj tashmë i ka konsoliduar, të cilat orientohen drejt ndikimit që mund të kenë sjellë shkeljet e parashtruara në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Nëse ndodhemi përpara zhvillimit të gjykimit në mungesë në Gjykatën e Rrethit Sarandë apo në Gjykatën e Apelit Tiranë, këto janë pretendime që sigurisht ngarkojnë kërkuesin me barrën e të provuarit. Megjithatë, fakti që, në rastin konkret, dosja gjyqësore nuk gjendet, do të thotë se edhe mundësia e të provuarit të pretendimeve të tilla bëhet e pamundur për arsye objektive dhe jo për faj të kërkuesit, siç arsyetojnë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të konkludojë se përderisa nga analiza e mënyra e të arsyetuarit të vendimeve gjyqësore dhe të të gjitha provave të tjera dhe në

mungesë të dosjes nuk arrihet të krijohet bindje e plotë mbi pretendimin e kërkuesit për zhvillimin e gjykimit në mungesë në të dy shkallët, atëherë ky pretendim nuk duhej vlerësuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në disfavor të tij. Dosja gjyqësore nuk mund të disponohet dhe as të ruhet nga palët në proces, pasi kjo është detyrë e vetë administratës gjyqësore. Mungesa e dokumenteve në dosjen gjyqësore apo humbja e të gjithë dosjes, ndërkohë që vendimet gjyqësore dhe provat e tjera nuk të krijojnë bindjen e plotë për pretendimet që ngrihen, nuk mund të shërbejnë si një argument për Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të nxjerrë përfundime jo të favorshme për kërkuesin.

Për të patur një proces të rregullt ligjor, detyrë e gjykatës së çdo shkalle mbetet që t'i garantojë secilës palë në proces përdorimin e të njëjtave armë, brenda mundësive përkatëse për t'i parashtruar çështjet në kushte të njëllojta me palën tjetër.

Pamundësia e kërkuesit për të provuar përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë pretendimet e ngritura, për arsye të cilat nuk mund të varen prej tij, por që lidhen me domosdoshmërinë e krijimit të kushteve për ruajtjen e dokumentacionit nga vetë gjykata, si dhe mënyra e të arsyetuarit dhe zgjidhja që këto Kolegje kanë dhënë, kanë ndikuar në thelbin e procesit, duke cenuar paanësinë dhe drejtësinë e tij. Kjo përbën shkelje të të drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim edhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të jurisprudencës së ndjekur nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Fakti që për këtë çështje mungon padia, provat e administruara, procesverbali gjyqësor, ankimi i palëve, pra çdo dokument bazë për një proces gjyqësor e vështirëson së tepërmi për gjykatën e çdo hallke nxjerrjen e konkluzionit për drejtësinë e vendimeve. Në mungesë të plotë të dosjes gjyqësore, nisur edhe nga qëndrimi që Gjykata Kushtetuese, por edhe vetë Gjykata e Lartë kanë mbajtur në raste të tilla analoge, ajo çmon të domosdoshme të ritheksojë se për të garantuar parimet kushtetuese të dhënies së drejtësisë dhe të rregullsisë së një procesi ligjor dhe të paanshëm, palëve u duhet dhënë mundësia që të parashtrojnë nga fillimi kërkesat dhe pretendimet e tyre, me qëllim zgjidhjen përfundimisht me drejtësi dhe paanësi të mosmarrëveshjes civile ndërmjet tyre.

Nga të gjitha argumentet e sipërcituara, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e bazuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë duhet pranuar.

PËR KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.471, datë 24.5.1996 të Gjykatës së Rrethit Sarandë; nr.199, datë 17.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.34, datë 11.4.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 40, datë 11.3.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""

Kujtim Puto	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi	Anëtar i	“““
Tefta Zaka	Anëtare e	“““
Petrit Plloçi	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi	Anëtar i	“““
Zija Vuci	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 16.11.2001 dhe 20.12.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.36/1 Akti që i përket:

KËRKUES:
1.GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANë, në mungesë.
2. PARTIA REPUBLIKANE E SHQIPËRISë, përfaqësuar nga Telja Mazniku, me autorizim.
SUBJEKTE TE INTERESUARA:
1. SHPËTIM STËRMASI, përfaqësuar nga Telja Mazniku.
2. FERIT TAHJA, përfaqësuar nga Telja Mazniku.
3. YLÇEZAR TORO, në mungesë.
4. LULËZIM SHALA, në mungesë.
5. SHOQERIA “M.LEKA”, përfaqësuar nga juristi Petrit Gaçe.
6. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Ilir Shurdhi, këshilltar juridik.
7. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Farudin Arapi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.8472, datë 8.4.1999 “Për rikthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga personat fizikë e juridikë, nëpërmjet shitjes së pasurive apo transaksioneve të pronësisë”.
BAZA LIGJORE: Nenet 131/a, 134/f, 145, 7, 11/3, 41/4 dhe 18 të Kushtetutës.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në shqyrtimin paraprak të këtyre kërkesave, vendosi që këto t’i bashkojë në një çështje të vetme sepse kanë të përbashkët jo vetëm objektin, por edhe shkaqet.
Për shfuqizimin si antikushtetues të këtij ligji kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe:
Nxjerrja e një ligji të tillë ka qenë krejtësisht e panevojshme, sepse problemet që ai trajton gjejnë rregullim të plotë në dispozitat e Kodit Civil. Këtë fakt jo se nuk e di ligjvënësi, por siç duket ai do t’i imponohet gjykatës vetëm për një rast të veçantë. Sidomos kjo antikushtetutshmëri vërehet qartë në nenin 3 të këtij ligji. Në kundërshtim me nenin 11 pikat 1 e 3 të Kushtetutës, kjo dispozitë kufizon lirinë e veprimtarisë ekonomike private dhe i kundërvihet parimit kushtetues, që garanton ekonominë e tregut.
Duke analizuar përmbajtjen e saj lidhur edhe me nenin 4 të ligjit nr.8472, datë 8.4.1999, del qartë se gjykata është e detyruar të vendosë pavlefshmërinë e kontratës së shitjes në funksion të çmimit dhe jo të gjykimit, pra ashtu siç është paravendosur nga ligji, i cili cenon në këtë mënyrë pavarësinë e pushtetit gjyqësor.
Ligji në fjalë vjen ndesh me parimin e lirisë kontraktore, nuk përfill mirëbesimin e palëve në shitjen e këtyre pasurive, si dhe nuk i përmbahet parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit dhe, në përgjithësi, parimeve të së drejtës civile, që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë e veprimeve juridike.
Një ligj i tillë krijon regres në marrëdhëniet ekonomike të shoqërisë dhe në të njëjtën kohë hap rrugën për shpronësime indirekte, duke shkelur në këtë mënyrë edhe parimin kushtetues të barazisë, sepse disa persona përjashtohen nga e drejta për të operuar në ekonominë e tregut me çmime të liberalizuara.
Përfundimisht, ky ligj, duke iu imponuar gjykatës, vjen ndesh edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet kushteve të parashikuara nga neni 7 i Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Shkaqet e parashtruara në dy kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese, njëra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe tjetra nga Partia Republikane e Shqipërisë janë pjesërisht të bazuara dhe të pranueshme për shfuqizimin si antikushtetues vetëm të nenit 3 të ligjit nr.8472, datë 8.4.1999 "Për rikthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga personat fizikë e juridikë nëpërmjet shitjes së pasurive apo transaksioneve të pronësisë", por jo edhe të ligjit në tërësi.

Në këtë dispozitë është parashikuar se "Personat fizikë e juridikë, vendas a të huaj, të cilët nëpërmjet fitimit të pronësisë nga privatizimi apo në mënyra të tjera kanë përfituar vlera financiare a pasurore nga subjektet e kontrollit a personat e lidhur me ta, nëpërmjet veprimeve juridike të shitjes së pronave me çmime më të larta se çmimi i privatizimit apo se çmimi mesatar përkatës i shitjes në tregun e lirë, detyrohen t'ia kthejnë ato administratorëve të shoqërive huamarrëse".

Përmbajtja e saj është e zbërthyer në nenet 1 e 2 të ligjit të sipërpërmendur, ku përcaktohen fusha e veprimit të tij, rrethi i personave që u adresohet, si dhe sqarohet kuptimi i termit "vlera për kthim", e cila përfaqëson diferencën midis çmimit të shitjes së pasurisë në shoqëritë huamarrëse dhe çmimit të privatizimit apo çmimit mesatar të shitjes së saj në tregun e lirë.

Duke analizuar përmbajtjen e nenit 3 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se papajtueshmëria e saj me Kushtetutën konsiston në këto drejtime:

Në radhë të parë, kjo dispozitë është në kundërshtim me nenin 11 pika 3 të Kushtetutës, që garanton lirinë e veprimtarisë ekonomike private. Si e drejtë kushtetuese kjo liri nënkupton detyrimin e shtetit të mos ndërhyjë në jetën dhe sferën e veprimtarisë së subjekteve private, që do të thotë se këta kanë autonomi dhe janë të lirë të përcaktojnë vetë kushtet dhe llojin e kontratave civile që do të lidhin me njëri-tjetrin, por me kusht që këto veprime juridike të mos vijnë në kundërshtim me normat urdhëruese të ligjit.

Është e vërtetë se, në bazë të nenit 11 pika 3 të Kushtetutës, kësaj lirie mund t'i bëhen kufizime vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike, por gjithmonë kur kjo veprimtari nuk ka filluar ose edhe kur ka filluar, por pasojat juridike të saj nuk janë ezauruar.

E parë në këtë këndvështrim del se përmbajtja e nenit 3 të ligjit objekt kërkese, nuk i përmbahet këtyre kritereve. Kufizimi që ajo ka vënë, duke parashikuar sanksione për shitjet e pasurive të privatizuara me çmime më të larta se çmimet e privatizimit prek marrëdhënie juridike civile, tashmë të konsoliduara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, d.m.th. ato marrëdhënie që janë krijuar dhe kanë përfunduar në kohën kur kanë qenë në fuqi ligje të tjera, të cilat nuk parashikonin ndalesa ose kufizime të kësaj natyre. Përkundrazi, në atë kohë subjektet e interesuara, si persona fizikë a juridikë privatë, ishin të lirë të bënin shitje midis tyre me çmimet reale të tregut, pavarësisht nga prejardhja e pronësisë mbi këto pasuri, nëpërmjet privatizimit apo në mënyra të tjera fitimi. Prandaj, zbatimi kundër tyre i sanksioneve të nenit 3 të ligjit objekt gjykimi, pasi ata kanë shlyer detyrimet ndaj njëri-tjetrit, tregon se kjo dispozitë i kundërvihet edhe parimit që ka të bëjë me veprimin e ligjit në kohë dhe fuqinë prapavepruese të tij.

Veç sa sipër, dispozita në fjalë i hap rrugën edhe shkeljeve që kanë lidhje me mosrespektimin e parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit, shkelje këto që shfaqen në formën e trajtimit të ndryshëm të situatave juridike të njëjta. Kështu, sanksioneve të kësaj dispozite u nënshtrohen jo të gjithë subjektet që kanë shitur me çmimin real të tregut pasuritë e tyre të privatizuara, por vetëm ata që këto veprime juridike i kanë kryer me shoqëritë huamarrëse, pa ditur ose pa qenë të detyruar të dinin për veprimtarinë e tyre të kundërligjshme.

Nga ana tjetër, zbatimi apriori i kësaj dispozite ndaj këtyre personave edhe pa praninë e kushteve të pavlefshmërisë së veprimeve juridike të parashikuara në Kodin Civil, është një imponim që i bëhet gjykatës që gjykon çështjen. Ky rregull i vendosur nga kjo dispozitë përbën tejkalim të pushtetit diskrecional të legjislativit dhe përligj ndërhyrjen e tij në sferën e veprimtarisë së gjyqësorit, duke cenuar kështu edhe parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës.

Pra, papajtueshmëria me Kushtetutën e nenit 3 të ligjit të sipërpërmendur shfaqet në disa drejtime dhe e bën të paevitueshme nevojën për shfuqizimin e tij.

Përsa i përket dispozitave të tjera të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese çmon se ato nuk përmbajnë në vetvete elementë që nuk pajtohen me frymën dhe normat e Kushtetutës. Rregullat e

vendosura prej tyre kanë karakter organizativ. Ato kanë për qëllim të nxisin administratorët e shoqërive huamarrëse për të evidentuar rastet e shitblerjeve të paligjshme dhe për të identifikuar personat që kanë vepruar me keqbesim në marrëdhëniet juridike me këto shoqëri rentjere.

Rregulla të tilla i shërbejnë shqyrtimit të shpejtë të këtyre çështjeve nga ana e gjykatave dhe sigurojnë ekzekutimin në afate sa më të shkurtra të vendimeve gjyqësore që përmbajnë detyrime ndaj atyre personave kur është vërtetuar se kanë edhe ata përgjegjësi për shitjet e pavlefshme të bëra në shoqëritë huamarrëse.

Nga ana tjetër fakti i pretenduar nga kërkuesit se këto dispozita të ligjit janë të panevojshme për shkak se problemet që trajtojnë gjejnë rregullim të plotë në dispozitat e Kodit Civil ose fakti se ato nuk janë formuluar si duhet nga pikëpamja e teknikës legjislative, janë çështje që i takojnë ligjvënësit dhe nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/a të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

V E N D O S I:

- Njëzëri, shfuqizimin si antikushtetues vetëm të nenit 3 të ligjit nr.8472, datë 8.4.1999 “Për kthimin në shoqëritë huamarrësve të vlerave financiare të përfituara nga personat fizikë e juridikë nëpërmjet shitjes së pasurive apo transaksioneve të pronësisë”.
- Me shumicë votash, rrëzimin e këtyre kërkesave në pjesët e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËRKESË

Kërkuese: Afërdita Ymeraj, lindur më 1954 në Vlorë dhe banuese në Martinë, komuna Levan, Fier.

Objekti: Kërkoj të shpallet i vdekur shtetasi Ali Ymeraj.

Më 4 shtator të vitit 1998 bashkëshorti im vendosi të emigrojë në Itali për të punuar. Si rezultat i kohës së keqe mbytet me gomone së bashku me shokët. Duke qenë se këto të dhëna i dha shtypi i ditës, si dhe televizioni dhe se për një periudhë për më shumë se dy vjet nuk kemi asnjë lajm, kërkoj të shpallet i vdekur bashkëshorti im Ali Ymeraj.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 18.3.2002
Doli nga shtypi më 19.3.2002

Tirazhi: 4230 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë